



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 10 nëntor 2016
Nr. ref.:RK1002/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI39/16

Parashtrues

Organizata Joqeveritare FINCA - Kosovë

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Rev. nr. 214/2015, të 1 shtatorit 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Organizata Joqeveritare FINCA - Kosovë, të cilën e përfaqëson z. Vigan Rogova, avokat nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 214/ 2015, i 1 shtatorit 2015, të cilin parashtruesi e pranoi më 20 tetor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, për të cilin parashtruesi pretendon se ia ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), sipas nenit 31 [Gjykimi i Drejtë dhe i Paanshëm] dhe nenit 49, paragrafi 1 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit].
4. Parashtruesi ka kërkuar nga Gjykata aplikimin e masës së përkohshme të ndalimit të të gjitha veprimeve përmbarimore dhe të procedurave gjyqësore deri në vendimin përfundimtar të kësaj gjykate.

Baza juridike

5. Neni 113.7, lidhur me nenin 21.4, i Kushtetutës; neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 29 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 20 shkurt 2016, nëpërmjet postës parashtruesi e dërgoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 14 mars 2016, Kryetarja e Gjykatës, me vendim, caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova, Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 8 prill 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 14 qershor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 22 mars 2004, parashtruesi në cilësinë e punëdhënësit kishte lidhur kontratë të punës me afat të pacaktuar me M. B. në cilësinë e punëmarrësit dhe kjo kontratë është nderprerë nga parashtruesi në vitin 2010 për arsye të shkeljeve të detyrave të punës nga punëtori.
11. Më 28 tetor 2011, Gjykata Komunale në Prizren ka aprovuar padinë e M.B. dhe ka detyruar parashtruesin që paditësin ta kthejë në pozitën e tij të punës, duke konstatuar se ai nuk kishte përgjegjësi për lëshimin e kredisë në rastin "B", pasi që kjo ishte përgjegjësi ekskluzive e komitetit të kredive të të paditurës.

12. Më 5 nëntor 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin AC. nr. 519/11, ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Kumunale.
13. Më 19 nëntor 2012, në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut parashtruesi e ka kthyer në punë M.B., me të cilin ka lidhur kontratë të re punësimi për kohë të caktuar.
14. Paralelisht me kthimin në punë të M.B., parashtruesi ka paraqitur në Gjykatën Supreme kërkesën për revizion, duke kundërshtuar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të cilin Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 66/2013, e ka refuzuar si të pabazuar.
15. Më 10 dhjetor 2012, parashtruesi me Vendimin HR 2012/89, e suspendoi nga puna M.B. pasi kundër tij kishte ngritur padi penale për shpërdorim detyre. Suspendimi është bërë për afat kohor të caktuar deri më 31 dhjetor 2013.
16. Më 4 janar 2013, parashtruesi i dërgoi M. B. njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, HR 2013/07, me të cilin e njoftoi se nga 31 janari 2013 atij i ka skaduar afati i kontratës së punës dhe se nuk do t'i vazhdohet më.
17. Më 15 janar 2013, i punësuar parashtroi padi pranë Gjykatës Themelore në Prizren, duke kontestuar mos vazhdimin e kontratës së punës.
18. Më 16 dhjetor 2014, Gjykata Themelore në Prizren ka marrë Aktgjykimin C. nr. 34/2013, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e parashtruar, ashtu që parashtruesi obligohet që ta kthejë paditësin në vendin e tij të punës dhe t'ia kompensojë të ardhurat personale.
19. Gjykata Themelore, në aktgjykimin e vet, ndër të tjera, kishte arsyetuar:

“Pas vlerësimit të provave të lartcekura, gjykata vlerëson se e paditura me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës paditësit nuk i ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit të Punës dhe si rezultat i kësaj vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është i paligjshëm, kjo për faktin se nga provat e nxjerra, nuk është vërtetuar që paditësi të jetë përgjegjës për shkeljet në punë në rastin ‘B ...’”. Gjykata Themelore po ashtu ka paraqitur faktin se Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës kishte urdhëruar parashtruesin që M. B. ta kthente në punë, si dhe faktin se Prokuroria Themelore në Prizren e kishte hedhur poshtë kallëzimin penal të parashtruesit ndaj M.B. me pretendimin për shpërdorim detyre.
20. Më 9 shkurt 2015, parashtruesi ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale.
21. Më 5 maj 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës ka marrë Aktgjykim AC. nr. 833/2015, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

22. Gjykata e Apelit, në arsyetimin e aktgjykimit të vet, kishte konstatuar:

“Në këtë gjendje të çështjes juridiko-civile, kjo gjykatë ka vlerësuar përfundimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se i njëjti është i drejtë dhe i bazuar, se ka mbështetje në provat e zhvilluara dhe në shkresat e lëndës dhe se janë dhënë arsyet e justifikueshme të cilat edhe kjo gjykatë i pranon”.

23. Më 3 qershor 2015, parashtruesi paraqet kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale.

24. Më 1 shtator 2015, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas kërkesës për revizion të parashtruesit, ka marrë Aktgjykimin Rev. nr. 214/2015, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për revizion.

25. Gjykata Supreme ka vlerësuar të gjeturat e gjykatave të instancave më të ulëta dhe ka konstatuar se *“është i pranueshëm qëndrimi juridik i gjykatave të shkallës më të ulët lidhur me pranimin si të bazuar të kërkesëpadisë së paditësit”.*

26. Gjykata Supreme gjithashtu ka konstatuar se në kuptimin e nenit 215 të LPK, *“kujdeset sipas detyrës zyrtare”* nëse ka pasur shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore gjatë procedurave të zhvilluara në gjykatat e instancave më të ulëta dhe në këtë rast aktgjykimet e gjykatave më të ulëta përmbajnë arsye për faktet vendimtare të vlefshme për gjykim të drejtë në këtë çështje juridike.

27. Gjykata Supreme ka vlerësuar edhe faktin lidhur me pretendimin e parashtruesit në revizion *“se zëvendësimi i kontratës me afat të pacaktuar me kontratën me afat të caktuar, nuk paraqet diskriminim, dhe se ndërprerja e marrëdhënies së punës paditësit nuk paraqet diskriminim”.* Megjithatë, Gjykata thekson se ky pretendim është i pabazuar sepse *“është parim universal në të gjitha procedurat ligjore se askush nuk mund të shpallet përgjegjës dy herë për të njëjtën çështje, andaj edhe paditësi nuk mund të shpallet përgjegjës dy herë për rastin ‘B...’”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me vendimet e kontestuarra i janë shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm (Neni 31 i Kushtetutës), duke pretenduar se gjykatat në mënyrë manifeste arbitrare e kanë bërë interpretimin e ligjit të aplikueshëm dhe të nenit 49, paragrafi 1 (E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit). Gjatë elaborimit të pretendimeve të tij, parashtruesi ka marrë për bazë disa nga vendimet e mëhershme të Gjykatës dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila, sipas tij, është e aplikueshme edhe në këtë rast.

Pranueshmëria e kërkesës

29. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregulloren e punës.

30. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

dhe

Nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], pika 4, ku përcaktohet:

“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.

31. Më tej, Gjykata merr në konsideratë nenin 48 të Ligjit (Saktësimi i kërkesës), i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

32. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, ku përcaktohet:

(1) *“Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

dhe

(2) *Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose...”.

33. Në vlerësimin e pretendimeve të ngritura nga parashtruesi, Gjykata vëren që kontestohet Aktvendimi Rev. nr. 214/2015, i 1 shtatorit 2015.

Neni 31. E drejta në Gjykim të Drejtë e të Paanshëm

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

[...]

Neni 49. E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit

“1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”.

34. Duke vlerësuar kushtetutshmërinë e aktgjykimit të kontestuar në relacion me pretendimet për shkelje të Kushtetutës dhe të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) dhe fakteve të prezantuara nga parashtruesi, duke i krahasuar këto fakte me përmbajtjen e dispozitave si më lart, Gjykata do të shqyrtojë veç e veç secilin prej pretendimeve të ngritura nga ana e tij.

Shkelja e pretenduar e nenit 31 të Kushtetutës – nenit 6 të KEDNJ-së

35. Para Gjykatës, parashtruesi ka pretenduar që shkelja e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ka ndodhur si pasojë e “interpretimit manifest arbitrar të ligjit”, sepse, sipas tij, nga arsyetimi i vendimit të Gjykatës Supreme, rrjedh se “zëvendësimi i kontratës së punës me afat të pacaktuar në kontratë në afat të caktuar paraqet situatë analoge me diskriminimin”.
36. Nga sa u tha më lart, Gjykata konstaton se Gjykata Supreme pretendimin e parashtruesit e kishte arsyetuar qartë, duke theksuar se askush nuk mund të shpallet përgjegjës dy herë për të njëjtën çështje sikur që parashtruesi ka vepruar kundërt të punësuarit M.B. Dhe çështja e ngritur nga parashtruesi nuk ka të bëjë fare me situatë analoge, me diskriminimin, por me një çështje të vlerësimit të përgjegjësisë eventuale tashmë njëherë të vendosur me një vendim gjyqësor. Gjykata, gjithashtu, shumë qartë kishte vlerësuar pretendimet për shkelje eventuale të dispozitave të procedurës kontestimore, duke theksuar se ajo nuk ka gjetur shkelje të tilla.
37. Gjykata rithekson se në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të rregullta nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që ushtron kjo Gjykatë ndaj vendimeve gjyqësore, është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, në rastin konkret të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. (Shih, ndër shumë të tjerë, rastin KI47-48/15, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-II-14-0057, të 12 marsit 2015, parashtrues *Beqir Kosokoviku e Mustafë Lutolli*).

38. Nuk është kompetencë e kësaj gjykate, që me vlerësimin vetanak të fakteve, të zëvendësojë vlerësimin e bërë nga ana e gjykatave të rregullta, sepse detyrë e kësaj gjykate është të vlerësojë nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm, ashtu sikur edhe kërkohet me nenin 6 të KEDNJ-së, respektivisht me nenin 31 të Kushtetutës. (Shih, ndër të tjera, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 16 dhjetor 1992, f. 34, seria A. nr. 247. dhe *Vidal kundër Belgjikës*, 22 prill 1992, f. 33, seria A, nr. 235).
39. Bazuar në parimin e subsidiaritetit, Gjykata nuk mund të marrë rolin e gjykatës së shkallës së katërt dhe nuk gjykon lidhur me rezultatin përfundimtar të vendimeve gjyqësore (Shih *Fc Metrebi v Georgia*, par. 31, aktgjykim i GJENDJ-së, i 31 korrikut 2007) dhe këtë fakt e ka potencuar edhe vetë parashtruesi duke theksuar se është i vetëdijshëm për kompetencën e Gjykatës Kushtetuese, ndonëse gjykuar sipas rrethanave të rastit del se qëllimi primar i tij duket të ketë qenë pikërisht kontestimi i rezultatit të procesit gjyqësor.
40. Gjykata më tej konstaton se pretendimi i parashtruesit lidhur me aplikueshmërinë e standardeve të përcaktuara juridike dhe të gjeturave konkrete nga GJEDNJ-ja, në rastin, *Barac dhe të tjerët kundër Malit të Zi*, aktgjykim i GJENDJ-së, i 13 dhjetorit 2011, edhe në rastin e tij në këtë gjykatë nuk janë referencë e saktë juridike.
41. GJEDNJ-ja, në rastin si më lart, kur kishte gjetur shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, kishte konstatuar se vendimi i Gjykatës së Lartë të Republikës së Malit të Zi ishte bazuar tërësisht në ligjin i cili nuk ishte në fuqi në momentin e marrjes së vendimit, sepse ai ligj paraprakisht ishte shpallur jokushtetues nga Gjykata Kushtetuese dhe ky fakt ishte vendimtar për rezultatin e gjykimit, ndërsa në rastin konkret të parashtruesit, këtu, të gjitha vendimet gjyqësore bazohen në ligjin i cili është në fuqi, i cili është tërësisht i aplikueshëm për rastin, ndërsa për mënyrën se si është interpretuar ligji dhe si është vlerësuar gjendja faktike, Gjykata Kushtetuese, bazuar në praktikën e saj tashmë konsistente, nuk mund të deklarohet sepse nuk është në kompetencën e saj.
42. Në këto rrethana të rastit, Gjykata nuk gjen se ka aplikim haptazi (manifest) arbitrar të ligjit dhe rrjedhimisht as shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë e të paanshëm.
43. Për më tepër, Gjykata konstaton se asgjë në rastin e prezantuar nga parashtruesi nuk provon se gjykatat e rregullta kanë dështuar të arsyetojnë vendimet e tyre dhe se procesi gjyqësor si tërësi, në rastin konkret ka qenë i padrejtë apo arbitrar, në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të gjejë se është cenuar vetë esenca e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Shkelja e pretenduar e nenit 49, E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit

44. Parashtruesi ka pretenduar gjithashtu se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 49 të Kushtetutës (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit) dhe, për të argumentuar këtë shkelje, në kërkesë kishte cituar *Komentarin* e Kushtetutës së Kosovës, e veçanërisht “... e drejta e

punës nuk do të thotë se çdo person ka të drejtë që t'i sigurohet punësimi, por mundësia për secilin që të sigurojë mjete për jetesë me punën e cila është zgjedhur dhe pranuar lirisht” dhe, më tutje “... kjo e drejtë nuk ia mundëson çdo individ që nga shteti, nëpërmes gjykatës, të kërkojë vend pune...” (Komentari, faqe 182, paragrafi nr. 3).

45. Dhe, më tutje *“pronarët e ndërmarrjeve private janë të lirë gjatë pranimi dhe largimit të fuqisë punëtore, kështu që kufizimet në pikëpamje të largimit më së shpeshti reduktohen në dëmshpërblim në rast të mosrespektimit të afatit të përjashtimit, largimit të kategorive të mbrojtura të punëtorëve, të punëtorëve të vjetër...”* (Komentari, faqe 183, paragrafi nr. 4).
46. Lidhur me si më sipër, Gjykata rikujton se neni 112 [Parimet e Përgjithshme] i Kushtetutës, ka paraparë:
 - “1. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.*
 - 2. Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësiave të saj”.*
47. Në këtë drejtim, Gjykata potencon se, me Kushtetutën e Kosovës, i është besuar asaj vetë ta interpretojë Kushtetutën, duke bërë vlerësimin kushtetues, ajo është plotësisht e pavarur, që do të thotë se nuk i nënshtrohet asnjë mandati tjetër detyrues përveç vetë Kushtetutës, andaj edhe interpretimin e të së drejtës së punës të garantuar me Kushtetutë e bën në mënyrë burimore, varësisht nga rrethanat e rastit konkret, nga provat e paraqitura në kërkesë dhe e pandikuar nga asnjë rrethanë tjetër e jashtme.
48. Gjykata vëren se referimi, edhe ashtu i shkëputur dhe selektiv, i *Komentarit të Kushtetutës* sa i përket nenit 49 të Kushtetutës, nuk mund të jetë referencë argumentuese për shkelje të Kushtetutës dhe për më tepër, edhe vetë autorët e Komentuarit kishin theksuar se *“ky libër mund të shërbejë si material njohës”*, pa i dhënëtribute të burimit të së drejtës, të cilat eventualisht mund të shërbejnë si normë juridike obligative për t'u ndjekur.
49. Parashtruesi, person juridik, nuk ka sqaruar se si është e aplikueshme e drejta e punës dhe zgjedhjes së profesionit në rastin konkret dhe nëse është e aplikueshme si është shkelur ajo. Në rrethanat kur me vendime gjyqësore të bazuara në ligjin e aplikueshëm dhe të arsyetuara gjerësisht parashtruesi obligohet ta kthejë në punë një të punësuar, nuk mund të provohet se ka pasur shkelje të nenit 49 të Kushtetutës.
50. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit për shkelje të neneve 31 dhe 49 të Kushtetutës nuk janë të mbështetura me prova, të cilat mund ta çojnë Gjykatën në përfundimin se ka pasur cenim të të drejtave kushtetuese andaj kërkesa duhet të deklarohet si qartazi e pabazuar.

Kërkesa për masë të përkohshme

51. Gjykata vlerëson se, pasi që kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar dhe, si e tillë, e papranueshme, edhe kërkesa për masë të përkohshme nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit dhe, rrjedhimisht, duhet të refuzohet.
52. Në përfundim, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese apo një të drejte të garantuar me KEDNJ, andaj, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika b dhe d, gjen se kërkesa është e papranueshme dhe qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më xx 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Arta Rama-Hajrizi

